

SHKURT 2024

NËNSHKRUHET KONVENTA HAGË-LUBJANË



TAKIM ME PERSONALITETET MË TË LARTA TË GJYKATËS NDËRKOMBËTARE PENALE

Ministri i Drejtësisë z. Ulsi Manja takon dy personalitete të larta të Gjykatës Ndërkombëtare Penale, Presidentin e GJNP z. Piotr Hofmański dhe z. Osvaldo Zava Giler, Kancelarin e GJNP. Vendimet e GJNP në jo pak raste kanë ndryshuar rrjedhën e ngjarjeve në vatra të caktuara të konflikteve ndërkombëtare dhe kanë sjellë paqe për njerëzimin. Fondi i besimit - i krijuar për të kompensuar viktimat e krimeve ndërkombëtare krahas ndëshkimit penal të autorëve të tyre - i jep kësaj gjykate dimensionin e bërjes së një drejtësie të plotë ndërkombëtare!

NËNSHKRIMI I KONVENTËS PËR MARRËVESHJET PËR ZGJEDHJEN E GJYKATËS DHE PROTOKOLLIT PËR LIGJIN E ZBATUESHËM PËR DETYRIMET USHQIMORE

Shqipëria nënshkruan Konventën për Marrëveshjet për Zgjedhjen e Gjykatës dhe Protokollin për Ligjin e Zbatueshëm për Detyrimet Ushqimore, në prezencë të z. Christophe Bernasconi, Sekretar i Përgjithshëm i Byrosë së Përhershme për të Drejtën Ndërkombëtare Private (HCCH) dhe z. Jules van Eijndhoven, MPJ Holandese. Nënshkrimi i Konventës për Marrëveshjet për Zgjedhjen e Gjykatës dhe Protokollit për Ligjin e Zbatueshëm për Detyrimet Ushqimore është një hap i rëndësishëm për Shqipërinë, në forcimin e legjislacionit të brendshëm në fushën e të drejtësisë ndërkombëtare private dhe një instrument shtesë për palët në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve civile! Konventa dhe protokoli që u nënshkrua nga z. Ulsi Manja, në emër të shtetit shqiptar, garanton universalitetin e të drejtës ndërkombëtare në të drejtën e brendshme, forcon sigurinë juridike për biznesin në marrëdhëniet tregtare ndërkombëtare, si dhe lehtëson procesin e dhënies së vendimeve për detyrimet ushqimore, në rastet që kanë të bëjnë me fëmijët në kontekstin e marrëdhënieve familjare!

